

Mariah "e obsesionuar"

Mbërrin nëpër radiot botërore single i parë i albumit të ri të Mariah Carey “Memoirs of an imperfect angel”. Ky single titullohet “Obsessed” dhe është shkruar nga vetë këngëtarja së bashku me The Dream dhe Tricky Stewart. Kënga ka filluar të luhet tashmë nëpër radio. Mariah është shumë e lumtur dhe veç të tjerash ka thënë: ”Kjo është një nga këngët e mia të preferuara të të gjitha kohërave. E dashuroj të gjithë albumin dhe e ndiej si një pjesë timen. Me zorr po pres që ’a dëgjoni edhe ju”. Në koverin e single-it, Mariah Carey duket në formë të shkëlqyer dhe super sexy. Besojmë ka pasur vend për goxha rregullime, sidomos po t'i referohemi lajmeve mbi shëndoshjen e saj me 7 kg.